

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi kryetar, Dr.sc.Driton Muharremi e Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve A.M. nga Peja për shkak të veprës penale të Vrasjes se mbetur në tentative nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim te paautorizuar te armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së si dhe I akuzuari F.B. nga Peja për shkak të veprës penale lëndim I lehtë truporë nga neni 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë, ankesës së të dëmtuarit F.B. dhe asaj të mbrojtësit të akuzuarit A.M. av. G.B., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Pejë PKR.nr.92/18 dt.28.01.2019 në seancën e kolegjit të mbajtur me 04.04.2019 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohen si të pabazuara ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë dhe ajo e të dëmtuarit F.B..

II.Aprovohet ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.M. si e bazuar, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, PKR.nr.92/18 dt.28.01.2019, vetëm përkitazi me vendimin për dënim, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës të akuzuarin A.M. për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) muaj në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 19.10.2018 e gjer me 28.01.2019, ndërsa dënimi me gjobë në shumë prej 500 euro i merret si i vërtetuar. Pjesa tjetër e aktgjykimit mbetet e pa ndryshuar.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Pejë me aktgjykimin PKR.nr.92/18 dt.28.01.2019, e ka shpallur fajtor të akuzuarin A.M. për shkak të veprës penale të Vrasjes se mbetur në tentative nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, për çka e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e në të cilin dënim me burg i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe atë nga dt. 19.10.2018 e gjer me 28.01.2019, ndërsa pjesën tjetër të mbetur të dënimit më burg i akuzuari do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim te paautorizuar te armëve nga neni 374 par.1 të

KPK-së e ka gjykuar me dënim me gjobë në lartësi prej 500(pesëqindtë) euro të cilin dënim do ta paguaj brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë sipas këtij aktgjykimi atëherë ky dënim me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20euro të dënimit më gjobë do ti caktohet një ditë burgim. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës t'ia paguaj shumën prej 100 euro në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësorë gjykatës ti paguaj 50 euro si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Të akuzuarin F.B. gjykata e gjakon me dënim me burgim prej 87 ditësh e në të cilin dënim me burg do ti llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga dt. 19.10.2018 e gjer me 13.01.2019 e që i bie 87 ditë arrest shtëpiak , dhe dënimi i shqiptuar me burg merret se dënim i vuajtur. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës t'ia paguaj shumën prej 100 euro në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësorë gjykatës ti paguaj 50 euro si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Për realizimin e kërkesës pasurorë juridike pala e dëmtuar udhëzohet në kontest te rregullt juridiko civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë kanë paraqitur:

-Prokurori i Prokurorisë Themelore në Pejë për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën dhe ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që të akuzuarit A.M. ti shqiptoj dënim me të lartë me burgim e me të cilin dënim do të arrihej qëllimi i ndëshkimit.

- I dëmtuari F.B. për shkak të vendimit mbi dënim me propozim që të aprovohet ankesa dhe të pandehurit A.M. ti jepet një dënim me i lartë.

-Mbrojtësit e të akuzuarit A.M. av. G.B. për shkak të shkeljes esenciale te dispozitave të procedurës penale, shkeljes së kodit penale dhe vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ne mënyrë që ta ndërroj cilësimin juridik të veprës penale dhe të pandehurit ti shqiptoj një dënim me të butë apo të njëjtin ta prish dhe lëndën ta kthej ne rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në të cilën prezent ishte i akuzuari A.M., mbrojtësi i tij av.G.B. dhe vëllai i të akuzuarit F.B.,i cili si i dëmtuar e ka autorizuar vëllain e tij R.L., ndërsa nuk prezantuan Prokurori i Apelit dhe i akuzuari F.B. edhe pse janë njoftuar me rregull për kohen dhe vendin e mbajtjes së seancës.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.108/19 të dt. 14.03.2019 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë dhe ajo e të dëmtuarit F.B., aktgjykimi i shkallës së parë të ndryshohet ashtu që të akuzuarit A.M. ti shqiptohet një dënim me i lartë se sa në

aktgjykimin e ankimuar. Kurse të refuzohet ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.M. av. G.B..

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa e Prokurorisë dhe ajo e të dëmtuarit F.B. janë të pa bazuara, kurse ajo e mbrojtësit të akuzuarit A.M. e bazuar vetëm sa i përket vendimit mbi dënim.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.M. av. G.B. konsideron se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës penale sepse dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës. Në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe dëshmitë vërtetohet kështu se i pandehuri (dëmtuari) F.B. është i pari që ka sulmuar të pandehurin A.M. dhe e ka goditur me dorë të revoles ku i ka shkaktuar lëndime trupore dhe i njëjti e ka drejtuar revolen kah i pandehuri A. dhe i njëjti ka ngec pastaj i pandehuri A. e ka nxjerr revolen e tij dhe ka nisur i pandehuri F. të ikë ku i njëjti ka gjuajtur në drejtim të veturës për tu mbrojtur nga i njëjti. Po ashtu gjykata ka shkelur edhe kodin penale kur ka aprovuar nga Prokuroria kualifikimin e veprës penale të vrasjes në tentativë ngase provat që ekzistojnë në shkresat e lëndës e që janë siguruar gjatë hetimeve tregojnë të kundërtën dhe atë se i pandehuri A. ka vepruar në vetëmbrojtje. Sa i përket vendimit mbi dënim i njëjti është shumë i ashpër.

Gjykata e Apelit me vëmendje ka shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit A.M., si dhe shkresat e lëndës dhe vlerëson se aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale por as shkelje të tjera të cilat kjo gjykatë sipas detyrës zyrtare është e obliguar të shqyrtojë. Siç shihet nga shkresat e lëndës i akuzuari ka pranuar fajësinë. Kjo për faktin se pretendimi i mbrojtjes kryekëput ka të bëjë me vërtetimin të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për të cilën mbrojtësi nuk ka pasur të drejtë ta atakoj pasi i akuzuari ka pranuar fajësinë në prani të mbrojtësit të tij dhe gjykata bazuar në dispozitat ligjore për pranim fajësie ka aprovuar të njëjtën dhe ka shpallur aktgjykimin si në dispozitiv të saj. Pavarësisht kësaj gjykata vlerësoi pretendimet e mbrojtjes dhe konstaton se nuk kemi shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe se aktgjykimi pavarësisht pranimin të fajësisë është bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe se është vepruar në përputhje me dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Meqë aktgjykimi nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nuk kemi as shkelje të Ligjit Penal e që do të kushtëzonte anulimin e aktgjykimit.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorisë, të akuzuarit F.B. në cilësinë e të dëmtuarit nuk janë të bazuara ndërsa ajo e mbrojtësit të akuzuarit A.M. është e bazuar. Në ankesën e Prokurorisë dhe të akuzuarit F.B. në cilësinë e të dëmtuarit nuk theksohen fakte dhe rrethana të reja e të cilat nuk i ka pasur Gjykata e shkallës së parë por Prokuroria vetëm shton se janë mbi vlerësuar rrethanat lehtësuese në krahasim me ato renduese ndërsa i akuzuari F.B. në cilësinë e të dëmtuarit thekson se dënimi i shqiptuar është i ulët kur kemi parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale , dënimi është minimal dhe tejet i ulët. Ndërsa kjo gjykatë konsideron se ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.M. është e bazuar duke pas parasysh rrethanën veçanërisht lehtësuese që është pranimi i fajësisë, pendimi i tij, me parë i pa dënuar moshë relativisht e re, se është bërë prind pak kohë më parë, faktin se i akuzuari tjetër i pari e ka goditur me kokë në pjesën e sipërme të hundës duke i shkaktuar lëndim të lehtë truporë, ashtu që edhe me një dënim me të butë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi mund të arrihet qëllimi i paraparë i dënimit paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 dhe 403 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.103/2019, më 04.04.2019

Procesmbajtëse,
Leonita Lajçi

Kryetar i kolegjit- gjyqtari
1. Xhevdet Abazi _____

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi _____

3. Afrim Shala _____